



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-054

Prishtinë, më 26 shkurt 2016, në orën 14:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 26 SHKURT 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Shefki Shoshaj.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari procedoi me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i veprimit të deputetëve për shkeljen e Rregullores së Kuvendit.

Kryetari lidhur me veprimet e deputetëve të opozitës, të cilët shkaktuan ndërprerjen e seancës së sotme plenare, datë 26 shkurt 2016, propozoi që disa deputetë nga opozita të përjashtohen nga Seanca plenare.

Kryesia e Kuvendit, pasi diskutoi lidhur me sjelljen dhe veprimet e disa deputetëve të opozitës, në seancën plenare më 26 shkurt 2016, të cilët penguan vazhdimin e punimeve të seancës plenare, me shumicë votash, mori këtë:

VENDIM

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Ismail Kurteshi, Faton Topalli, Time Kadriu, Pal Lekaj, Bali Muharremaj dhe Teuta Haxhiu largohen nga pjesëmarrja në seancën plenare më 26 shkurt 2016 për shkak se me sjelljet dhe veprimet e tyre që e pamundësuan vazhdimin e punimeve të seancës plenare.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*